

UNIVERSITETI “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
MASTER-PROGRAMI FINANCIAR



DIGJITALIZIMI I EKONOMISË DHE RREGULLAT E REJA TATIMORE

Mentori:

Prof. Dr. Bedri Peci

Kandidatja:

Arlinda Ahmeti Kastrati

Prishtinë, 2025

ABSTRAKT

Materiali i këti punimi analizon efektet e ekonomisë dixhitale dhe rregullat e reja tatimore në Kosovë, në rajon dhe botë.

➤ Digjitalizimi i ekonomisë

Në punim kam paraqitur sfidat kryesore që ekonomia dixhitale ka në Kosove dhe në vende të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. Gjatë viteve të fundit kemi parë edhe përmirësime teknologjike të avancuara çdo herë e më shumë, këto janë të rëndësishme pasi që identifikimi dhe menaxhimi mund të monitorohen më lehtë dhe më saktë.

Ekonomia digjitale ne Kosovë paraqet një sektor të së ardhmes që përfaqëson shumë vlera të domosdoshme për zhvillimin ekonomik. Përveqse që ndikon në avancimin brenda fushës së caktuar, ka edhe nje atribut tjetër: të ndërlihdjes të të gjithë sektorëve të ekonomisë. Kosova është duke u rindërtuar në aspektin ekonomik mirëpo gjatë rrugës ka hasur edhe në pengesa që do ti analizojmë.

➤ Rregullat e reja tatimore

Gjatë punimit kam bërë përpjekje që të hulumtojmë, të trajtojmë në mënyrë shkencore mbi problematikën e sistemit dhe politikave tatimore, mbi zhvillimin dhe funksionimin e tyre në shtetet e ndryshme me theks të veçantë në Republikën e Kosovës duke i krahasuar me vendet e rajonit dhe rrethit global.

Në këtë punim do të analizojmë ndryshimin e rregullave tatimore të përbërës së më hershme dhe kohes së tashme. Ndryshimi i procedurave dhe rregullave tatimore pas gjendjes me pandemi u pa se ishte më se i nevojshëm.

Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përafërt me atë të BE-së. Kjo vlen për tatimet dhe politikat doganore duke përfshirë tatimet direkte dhe indirekte. Sistemi tatimor në Kosovë përbën një pako ligjesh tatimore dhe udhëzimesh administrative. Në këtë punim do të analizojmë ndryshimet e rregullave tatimore në Kosovë dhe në Bashkimin Evropian.